

ROSAMUNDE PILCHER

**SHTATORI**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA



ROSAMUNDE PILCHER

# SHTATORI

roman

Përktheu nga origjinali anglisht  
Shpresa Osmeni

BOTIMET TOENA  
Tiranë

Autori: Rosamunde Pilcher (Rozamunde Pilçër)

Titulli në origjinal: September

Botoi në anglisht: Hodder

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376732

© Robin Pilcher, Fiona Pilcher, Mark Pilcher and Philippa Imrie 1990

All rights reserved.

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

MAJ



*E martë, datë tre*

Vera erdhi në Skoci, më në fund, nga fillimi i majit. Dimri, ishte mbërthyer me gishtërinjtë e tij të fortë prej çeliku, për një kohë shumë të gjatë duke mos dashur të hiqte dorë nga shtrëngimi i tij mizor. Gjatë gjithë prillit, erërat e forta kishin fryrë nga veriperëndimi duke larguar me forcë lulëzimin e hershëm të luleve dhe duke marrë me vete lulet e fishkura. Dëbora i kishte ngrirë majat e kodrave dhe ishte shtrirë thellë nëpër zgavrat e tyre, ndërsa fermerët, të dëshpëruar për kullotat e hershme, kishin grumbulluar ushqimin e tyre të fundit me traktor në fushat djerrë, ndërkohë rezervat e ushqimit ishin vënë pas mureve të gurta.

Madje edhe patat e egra, që zakonisht largoheshin në fund të marsit, tashmë po ktheheshin me vonesë në vendet e Arktikut. Tufat e tyre të fundit në fluturim ishin zhdukur rreth mesit të prillit duke gagaritur drejt veriut, drejt qiejve të panjohur, duke fluturuar aq lart saqë formacionet në formë shigjetash ngjanin si rrjeta merimangash që i kishte marrë era.

Dhe më pas, nga nata në mëngjes, klima e paqëndrueshme e malësisë zbutej. Era ndërronte drejtimin drejt jugut, duke sjellë me vete flade qetësuese dhe motin e butë, i cili për javë të tëra kishte kënaqur pjesën tjetër të vendit me aromën e freskisë së tokës dhe me gjithçka që po rritej e lulëzonte. Fshatit iu rikthye ngjyra e ëmbël e gjelbër. Pemët e qershivë të egra, u rimëkëmbën nga dëmtimet që kishin pësuar, morën forcë dhe degët e tyre u mbështollën nga një mjegull petalesh borë të bardha. Menjëherë kopshtijet filluan të lulëzonin me ngjyra të ndryshme: lulet e verdha të jaseminit, manushaqet ngjyrë lejla dhe zymbylat me ngjyrë blu të errët.

Zogjtë po këndonin dhe dielli, për herë të parë, që nga vjeshta e kaluar, solli me vete edhe ngrohtësinë e tij.

Çdo mëngjes, gjatë gjithë jetës së saj, Violeta Eird, në shi ose në diell, ecte nëpër fshat për të blerë në supermarketin e zonjës Ishak dy litra qumësht, gazetën “The Times”, sasi të vogla ushqimesh dhe sende të tjera të nevojshme, si edhe mjete të tjera jetese për një grua të moshuar që jetonte e vetmuar. Vetëm ndonjëherë në zemër të dimrit, kur pirgjet e dëborës kishin mbuluar vendin dhe akulli bëhej i pabesë, ajo i shmangej kësaj situate, sipas parimit se maturia ishte pjesa më e mirë e guximit.

Nuk ishte e lehtë të zbrisje gjysmë milje poshtë rrugës së pjerrët, ndërmjet fushave që dikur kishin qenë parku i Kroit, çifligu i Arçi Balmerinos dhe më pas një ngjitje e vështirë gjysmë milje për në shtëpi. Ajo kishte një makinë dhe fare mirë mund ta kishte bërë rrugën me të, por bindja e saj se kur moshja e vjetër kacavirret drejt nesh dhe fillon e përdor makinën për udhëtime të shkurtra, atëherë mund të jesh në rrezik të humbësh kontrollin e këmbëve. Gjatë muajve të gjatë të dimrit asaj do t’i duhej që të përgatiste dengjet e rrobave për këtë ekspeditë: çizme, triko, xhaketa kundër ujit, shaje, dorashka, kapela prej leshi që mbulonin veshët. Këtë mëngjes kishte veshur një fund prej leshi dhe mbi të kishte një triko të trashë, ndërsa kokën e kishte të zbuluar. Dielli ia rriste humorin, ndihej më e re dhe më energjike dhe, duke qenë e dhënë pas veshjeve pa shije, kjo i kujtonte kënaqësitë e fëmijërisë kur braktiste çorapet e zeza, të leshta, dhe ndiente përkëdheljen e ajrit të freskët në këmbët e saj të zbuluara.

Dyqani i fshatit këtë mëngjes gumëzhinte nga njerëzit dhe asaj i duhej që të priste pak kohë që t’i shërbenin. Zonja Ishak nuk e çante kokën, sepse kështu do të kishte mundësi që të bisedonte me klientët e tjerë, pasi shumë prej tyre ishin fytyra të njohura. Ata bisedonin për motin, pyesnin për shëndetin e nënave të tyre, vështronin se si një fëmijë zgjidhte me kujdes një lloj ëmbëlsire të cilën do ta paguante me paratë e veta, por nuk nxitonte kur i duhej të merrte vendimin. Dhe, kur më në fund atij i mbushej mendja, zonja Ishak ia vendoste ëmbëlsirën në një qese prej letre dhe pastaj ia merrte paratë.

- Nuk duhet t’i hash të gjitha njëherësh, në të kundërt do të të prishen dhëmbët, - i tha ajo vogëlushit.

- Mirëmëngjesi, zonja Eird.

- Mirëmëngjesi, zonja Ishak. Oh, sa ditë e bukur është sot!



- Nuk mund ta besoja kur pashë diellin që po shkëlqente. - Zonja Ishak, që kishte mërguar në këtë klimë veriore nga dielli i pamëshirshëm i Malovit, ishte mbështjellë me një triko të trashë dhe mbante një ngrohës me parafinë mbrapa banakut ku grumbulloheshin blerësit. Megjithatë, këtë mëngjes ajo dukej shumë e lumtur. - Mendoj se moti do të ftohet përsëri.

- Ndërsa unë nuk mendoj kështu. Vera ka ardhur. Oh, faleminderit, qumështi dhe pecetat e mia. Ndërsa Edi do një lustrues mobilie dhe një top letre. Mendoj se do të bëja mirë që të blija edhe nja gjashtë vezë.

- Në qoftë se çanta jote është shumë e rëndë, do të ta dërgoj me motor në shtëpi, me zotin Ishak.

- Jo, faleminderit, mund ta mbaj edhe vetë.

- Por ke për të bërë një rrugë të gjatë.

Violeta buzëqeshi:

- Por, e di ti sa mirë më bën kjo mua?

E ngarkuar, ajo u nis për në shtëpinë e saj në Peniburn. Zbriti nga trotuari, kaloi nëpër rreshtat e shtëpive të vogla, me ato dritaret që reflektonin dritën e diellit dhe me dyert e hapura për të marrë ajrin e ngrohtë e të freskët; pastaj rruga kalonte ndërmjet portave të Kroit deri lart në kodër. Kjo ishte një rrugë private, pjesa e pasme e së cilës të çonte në një shtëpi të madhe. Shtëpia në Peniburn ishte në mes të rrugës, në një anë rrethohej nga fushat e pjerrëta. Ishte pranë një rrugice të pastër e të rrethuar me gardhe ahu, të krasitura, dhe gjithmonë ndieje njëfarë lehtësimi kur e dije se nuk do të ngjiteshe më tej.

Viola mezi po e mbante shportën e saj të rëndë, të cilën e kalonte sa në një rëndë dorë e sa në tjetrën dhe në të njëjtën kohë bënte plane në mendjen e saj: si do ta kalonte pjesën tjetër të ditës. Ky ishte një nga ato mëngjes kur Edi e ndihmonte Violetën, që do të thoshte se Violeta do të linte punët shtëpisë dhe do të merrej me punët në kopsht. Kohët e fundit bënte shumë ftohtë dhe ajo i kishte lënë pas dore punët në kopsht. Lëndina, pas atij dimri të gjatë, dukej e lodhur dhe e mbuluar nga myshku. Ndoshta ajo duhej të bënte krasitje për të lejuar lëvizjet e ajrit të pastër. Më pas i duhej të përgatiste një përzierje plehu për spërkatjen e trëndafilishtës. Perspektiva e mbushte me një kënaqësi të madhe. Mezi po priste që të fillonte punën.

Hapat e saj u shpejtuan, por papritmas ajo pa një makinë të panjohur që kishte parkuar jashtë portës së saj dhe tashmë e dinte se për momentin kopshti duhej të priste. Një vizitor. Çfarë irritimi. Kush kishte ardhur? Me

kë duhej të ulej dhe të bisedonte, në vend që të merrej me gërmimet e kopshtit?

Makina ishte një “Renault” e vogël, e pastër dhe, pa dyshim, burri që e ngiste ishte pronari i saj. Violeta hyri në shtëpi nëpërmjet derës së kuzhinës dhe atje gjeti Edin që po mbushte ibrikun me ujë në çezmë.

Ajo e përplasi shportën mbi tavolinë.

- Kush është? - mermëriti duke bërë gjeste me dorë.

Edi, gjithashtu, foli me zë të lartë:

- Zonja Stejton. Nga Korrihilli.

- Sa kohë ka që ka ardhur?

- Pak më parë. I thashë të priste. Është në dhomën e ndenjjes. Ka një fjalë të vogël për të të thënë.

Edi foli me zërin e saj normal:

- Po bëj një kafe për të dyja. Do të ta sjell brenda sapo të jetë gati.

Pa i kërkuar falje, shkoi që të gjente vizitoren e saj. Verena Stejton po qëndronte te dritarja, dielli kish depërtuar në të gjithë dhomën, ndërsa ajo po vështronte nga jashtë kopshtin e Violetës.

Kur Violeta hyri në dhomë, ajo u kthye.

- Oh, Violeta. Më vjen keq. Ndihem e turpëruar. I thashë Edit se do të vija njëherë tjetër, por ajo u betua se ti do të ktheheshe në shtëpi nga çasti në çast.

Ajo ishte një grua e gjatë, e hollë, rreth të dyzetave, e pastër, elegante. Menjëherë dallonte nga zonjat e tjera të fshatit, nuk kishte tendencën për t’u dukur dhe as nuk e shqetësonte fakti si dukej nga pamja e jashtme. Verena dhe burri i saj, Angusi, sapo kishin ardhur në atë lagje, ata kishin jetuar në Korrihill për më shumë se dhjetë vjet. Më parë, Angusi kishte punuar si shitblerës aksionesh në Londër, por pasi kishte marrë një dorë të mirë parash, kishte blerë një shtëpi në Korrihill, dhjetë milje larg nga Strathkroi dhe ishte vendosur në veri me gruan dhe vajzën e tij, Kejtin. Kishin kërkuar aty rrotull për ndonjë punë që nuk kërkonte ndonjë profesion. Ai sapo kishte mbyllur një biznes me lëndë drusore në Relkirk dhe gjatë viteve e shndërroi atë në biznes fitimprurës.

Për sa i përket Verenës, edhe ajo ishte një grua karriere, ishte tërësisht e përfshirë në një organizatë që quhej “Organizata Skoceze e Udhëtimit”. Gjatë muajve të verës, kjo kompani lëvizte autobusët e mbushur plot me vizitorë amerikanë andej-këndeje. Kompania, gjithashtu, merrej me sistemimin e vizitorëve, si miq me pagesë, nëpër shtëpi private. Izabel

Balmerino, gjithashtu, ishte e përfshirë në këtë detyrë të vështirë, që për Violetën nuk mund të kishte ndonjë mënyrë më të lodhshme për të bërë pak para.

Megjithatë, nga pikëpamja sociale, familja Stejton e kishte konsideruar veten si një aset të vërtetë për komunitetin duke qenë edhe miqësore, edhe pa pretendime, zemërmirë, mikpritëse dhe gjithmonë e gatshme për organizimin e festave, për të drekuar në restorante, si dhe për veprimtari të tjera për grumbullim njerëzish dhe parash.

Megjithatë, Violeta as nuk mund ta imagjinonte se përse Verena ndodhej këtu.

- Jam shumë e kënaqur që qëndruat. Do të më kishte ardhur keq po të mos ju takoja. Edi po na bën nga një filxhan kafe.

- Duhej t'ju kisha telefonuar, por isha duke udhëtuar për në Relkirk dhe papritur mendova që do të ishte më mirë të vija e të mos e humbja shansin që t'ju takoja. Diçka m'u shkrep në atë moment. Nuk e keni problem?

- Jo, jo, aspak, - gënjeu Violeta. - Urdhëroni dhe uluni. Kam frikë se zjarri nuk është ndezur akoma, por...

Ajo u rehatua vetë mbi divan dhe u ul këmbë mbi këmbë. Violeta disi e çliruar u ul në karrigen e saj dhe vendosi të futej drejt e në temë.

- Edi më tha që ju dëshironit të bisedonit me mua.

- Unë, papritmas mendova... Ju do të ishit njeriu i duhur për të më ndihmuar.

Zemra e Violetës rrahu fort, duke përfytyruar pazaret, hapjet e kopshteve apo koncertet e bamirësisë për të cilat ajo duhej pyetur; kuptohet për shitje biletash.

- Ndihmë? - tha ajo shkarazi.

- Jo, jo mirëfilli ndihmë, më shumë disa këshilla. Siç e keni dëgjuar, unë po mendoj për të organizuar një mbrëmje vallëzimi.

- Një mbrëmje vallëzimi?

- Po. Për Kejtin. Ajo do të mbushë njëzet e një vjeçe.

- Por, si mund t'ju këshilloj unë? Nuk më kujtohet ta kem bërë një gjë të tillë ndonjëherë. Sigurisht, do të bënit mirë të pyesnit dikë që është më i informuar për këtë. Për shembull, Pegi Ferguson Kremienin, ose Izabelën.

- Pikërisht këtë po mendoja... Ju keni kaq shumë përvojë. Keni jetuar në këtë vend më shumë se çdo njeri që njoh. E di. Doja të merrja mendimin tuaj për këtë ide.

Violeta mbeti e shtangur. Duke vështruar rreth e qark dhe duke u menduar për çka do të thoshte, e mirëpriti hyrjen e Edit me tabakanë e kafesë. Edi e vendosi atë mbi një stol të vogël pranë zjarrit. Dhe pyeti:

- Dëshironi biskota?

- Jo, Edi, megjithëse shkojnë me kafënë. Faleminderit shumë.

Edi u largua. Për një moment u dëgjua zhurma e fshesës me korrent në katin përdhes.

Violeta hodhi kafënë në filxhan.

- Çfarë kishit në mendje?

- Oh, ju e dini, bobinat e magnetofonit dhe kërcimet me muzikë *country*.

Violeta mendonte se ajo e dinte.

- Po thoni për kasetat në magnetofon dhe vallëzimet tetëshe në skenë.

- Jo. Jo vetëm aq. Një kërcim vërtet të madh. Do ta realizojmë me njëfarë performace. Me një tendë të ngritur mbi lëndinë...

- Shpresoj që Angusi të ndihet i qetë.

Verena e injoroi këtë ndërhyrje: - Si dhe një bandë të veçantë për muzikë. Do të përdorim sallën, natyrisht edhe dhomën e vizatimit. Jam e sigurt që Kejti do të dojë një disko për të gjithë miqtë e Londrës dhe me sa duket kjo është një gjë që duhet realizuar. Ndoshta dhoma e ngrënies. Ne mund ta kthejmë në një lloj guve apo shpelle.

“Guvë dhe shpellë”, mendoi Violeta. Ishte e qartë që Verena e kishte bërë punën e saj. Me sa duket ajo kishte qenë një organizatore e shkëlqyer. Violeta iu përgjigj me qetësi:

- Ju i paskeni bërë planet tuaja.

- Kejti mund t'i ftojë të gjithë miqtë e saj nga jugu... dhe neve na duhet të gjejmë shtretër për ta, natyrisht...

- Keni biseduar me Kejtin për idenë tuaj?

- Jo, jua thashë juve. Jeni njeriu i parë që e dini.

- Oh, por ndoshta ajo nuk dëshiron një mbrëmje vallëzimi.

- Sigurisht që do të dojë. Ajo gjithmonë i ka dashur mbrëmjet.

Violeta, duke e njohur Kejtin, gjykoi se kjo ndoshta ishte e vërtetë.

- Dhe kur do të bëhet kjo?

- Po mendoja për në shtator. Është koha e duhur. Shumica e njerëzve janë në gjueti dhe ndërkohë të gjithë janë me pushime. Data gjashtëmbëdhjetë mund të jetë një datë e mirë, sepse deri atëherë shumica e fëmijëve të vegjël do të kenë shkuar nëpër shkolla me konvikte.

- Tani jemi në maj. Shtatori është ende larg.

- E di, por kurrë nuk është shumë herët për të caktuar një datë dhe për të filluar përgatitjet. Mua do të më duhet që të rezervoj tendat dhe kateringun, të përgatis ftesat... - Befas asaj i lindi edhe një ide tjetër. - Dhe, si thoni, Violeta, a nuk do të ishin edhe dritat një gjë e bukur, që të vendoseshin gjatë gjithë rrugës deri te shtëpia?

Gjithçka dukej mjaft ambicioze.

- Do të keni shumë punë për të bërë.

- Jo në të vërtetë. Deri në atë kohë edhe dyndja turistike do të ketë mbaruar, sepse mysafirët me pagesë nuk vijnë më pas fundit të gushtit. Do të kem mundësinë të jem më e përqendruar. Por duhet ta pranojmë, Violeta, është një ide e mirë. Dhe mendo që, në këtë mënyrë, mund t'i ftoj të gjithë njerëzit që kam detyrim dhe ta kem ndërgjegjen të pastër. Të gjithë njëherësh, duke përfshirë edhe Barëllsat, - tha ajo.

- Nuk mendoj se i njoh Barëllsat.

- Jo, jo, nuk duhet t'i keni njohur ata. Janë kolegë biznesi të Angusit. Kemi qenë tek ata për darkë dy herë. Dy mbrëmje shumë të mërzitshme. Dhe nuk i kemi ftuar, thjesht sepse nuk gjenim njeri që mund të duronte një mbrëmje tepër të bezdisshme, të mërzitshme. Nëse ia kujtoj Agnusit ata njerëz, nuk do ta ketë problem të firmosë në çast disa çeqe.

Violetës i erdhi keq për Angusin dhe tha:

- Kë tjetër do të thërrisni?

- Oh, të gjithë. Millburnsat dhe Ferguson-Krombin, Bukanan Rajtsin, zonjën Uesterdejell, Brendsat dhe Strafordsat. Tashmë të gjithë fëmijët e tyre janë rritur, kështu që edhe ata duhen ftuar, gjithashtu. Midëlltonsat do të vijnë nga Hempshajeri dhe Luardstët nga Gluçestershajeri. Do të bëjmë një listë. Unë do të vendos një letër në vendin e lajmërimeve në kuzhinë dhe kurdoherë që të më kujtohet ndonjë emër i ri, do ta shënoj në listë. Sigurisht, edhe ju, Violeta. Edmundi, Virxhinia dhe Aleksa, edhe Balmerinsat. Izabela do të shtrojë një darkë për mua, për këtë jam e sigurt...

Papritur, gjithçka filloi të dukej e lezetshme. Përqendrimi i Violetës e ktheu atë në të kaluarën, te situatat e harruara që i erdhën ndër mend. Pa menduar fare, tha:

- Duhet t'i dërgoni edhe Pandorës një ftesë.

Çdo kujtim pasohej nga një tjetër, dhe ajo nuk e kuptoi përse pati këtë sugjerim kaq impulsiv.

- Pandora?

- Motra e Arçi Balmerinos. Kur njerëzit mendojnë për festat, automatikisht ata mendojnë Pandorën. Por, sigurisht që ju nuk e keni njohur atë.

- Po, di disa gjëra për të. Për disa arsye emri i saj gjithmonë shfaqet në bisedat e mbrëmjeve. Mendoni se do të vijë? Me siguri ajo nuk ka qenë në shtëpi për më shumë se njëzet vjet?

- Kjo është e vërtetë. Thjesht një mendim budalla. Por pse të mos e provoni? Çfarë goditje do të jetë për të gjorin Arçi? Dhe nëse ka ndonjë gjë që do ta sillte atë endacake përsëri në Kroi, do të ishte karremi i një kërcimi të vërtetë.

- Atëherë jeni në anën time, Violetë? Mendoni që të vazhdoj përpara dhe ta bëj këtë?

- Po, kështu mendoj. Në qoftë se ju keni energjitë dhe paratë, mendoj se është një ide e shkëlqyer. Do të na japë diçka të mrekullueshme.

- Mos e bisedoni derisa ta kem pleqëruar me Angusin.

- Asnjë fjalë.

Verena buzëqeshi e kënaqur. Dhe më pas një mendim tjetër i erdhi në mendje:

- Po ju kërkoj lejë të largohem, - tha ajo, - që të shkoj për të blerë një fustan të ri për veten time.

Violeta nuk e kishte një problem të tillë.

- Unë, - i tha ajo Verenës, - do të vesh fustanin tim të zi prej kadifeje.

## 2

*E enjte, datë dymbëdhjetë*

Nata ishte e shkurtër dhe ai nuk fjeti. Së shpejti do të agonte. Kishte imagjinuar se do ta zinte gjumi menjëherë pasi ishte i lodhur dhe i rraskapitur. I rraskapitur prej tri ditësh nga vapa e jashtëzakonshme për stinën. Në Nju-Jork ditët ishin të mbushura me mbledhjet e mëngjesit, drekat e biznesit, pasditet e gjata me diskutime e zënka, me shumë kokakola dhe me kafe të zezë, shumë pritje dhe net të vona dhe një mungesë e tmerrshme ajri të pastër dhe ushtrimesh fizike.

Më në fund u arrit një sukses, megjithëse nuk ishte e lehtë. Harvi Klein ishte kokëkrisur dhe duhej bindur se kjo ishte rruga më e mirë për të kapur tregun anglez. Fushata krijuese, që Noeli kishte sjellë me vete në Nju-Jork, e plotësuar me afatet kohore që ishin caktuar dhe me fotografitë, ishte aprovuar dhe kishin rënë dakord. Me kontratën në xhep, Noeli mund të kthehej në Londër. Mori çantën e tij, bëri një telefonatë në minutën e fundit, e mbushi çantën me dokumente dhe me makinën llogaritëse, mori edhe një telefonatë që i uronte një udhëtim të mbarë, zbriti poshtë në rrugë, mori një taksi dhe u nis drejt aeroportit “Kennedy”.

Në mbrëmje Manhatani, i ndriçuar si zakonisht, dukej i mrekullueshëm; dritat e kullave nxirrnin kryet e tyre duke flakëruar qiellin. Ishte një qytet që të ofronte çdolloj forme kënaqësie.

Më parë, në vizitat e mëparshme, ai i kishte përdorur të gjitha përparësitë e argëtimit, por këtë herë nuk kishte mundësi që të pranonte asnjërën prej tyre. Atij i kishte mbetur peng që nuk kishte realizuar ndonjëherë nga veprimtaritë a thua sikur të ishte larguar nga një mbrëmje fantastike përpara se të kishte filluar të argëtohej.

Në aeroportin “Kennedy” taksia ndaloi dhe e la në terminalin “AB”. Hyri në radhë në kohën e duhur, kaloi kontrollin, dorëzoi bagazhet, zuri radhën përsëri te zyrat e kontrollit dhe më në fund avioni. Bleu një shishe uiski, gazetën “Newsweek”. Pasi gjeti një karrige, u ul i lodhur dhe priste që të nisej avioni.

Si favor i Uenbornit dhe Ueinburgut, ai do të udhëtonte në klasin e parë, kështu të paktën do të kishte vend të mjaftueshëm për këmbët e tij të gjata; kishte kërkuar një vend pranë dritares. Hoqi xhakëtën, u rehatua, dëshironte të pinte diçka. Atij iu duk se do të ishte e rastësishme nëse askush nuk do të vinte për t’u ulur pranë tij, por kjo shpresë e vakët u zhduk pothuajse kur një person i veshur mirë, me një kostum me vija, e zuri atë vend duke vendosur çanta të ndryshme në vendin e caktuar për të dhe më në fund u përplas krahas tij.

Burri zuri një pjesë të madhe të vendit. Pjesa e brendshme e avionit ishte e freskët, por ky njeri kishte vapë. Ai nxori një shami mëndafshi dhe fshiu ballin, ulej e ngrihej dhe gulçonte, kërkonte për rripin në karrige dhe iu afrua Noelit duke e lënduar me bërryllin e tij.

- Më falni. Më duket se jemi shumë të ngarkuar sot?

Noeli nuk dëshironte që të fliste. Ai buzëqeshi dhe tundi kokën, hapi gazetën e tij “Newsweek”.

U nisën. Në fillim u shërbyen koktejet dhe më vonë darka. Nuk ishte i uritur, por hëngri se donte të kalonte kohën dhe se nuk kishte asgjë tjetër për të bërë. Avioni i madh 747 fluturoi mbi Atlantik. Mbasi darka përfundoi, filloi filmi. Noeli e kishte parë atë film në Londër. Kështu që i kërkoj stjuardesës një uiski me ujë të gazuar dhe e piu ngadalë duke tundur gotën derisa i dha fund. Dritat u fikën dhe pasagjerët zgjatën duart për të marrë jastëkët dhe kuvertat. Burri i shëndoshë vendosi duart mbi stomak dhe menjëherë filloi të gërhiste. Noeli mbylli sytë, por kjo gjë e bëri që të ndihej sikur ishte i mbuluar me rërë. Kështu që i hapi përsëri. Mendja e tij fluturonte. Kishte punuar afërsisht për tri ditë pa pushim, pa e ulur ritmin, pa lënë asgjë në harresë.

Po habitej përse nuk ndihej triumfator, pasi kishte fituar një llogari të çmuar dhe po kthehej në shtëpi me të gjitha gjërat e kopsitura; me torbat plot. Një metaforë e përshtatshme përfitimi... torbat. Ishte një nga ato fjalë të cilën sa më shumë e përmendim, aq më qesharake duket. Por nuk ishte për të qeshur.



Ishte jashtëzakonisht e rëndësishme jo vetëm për Noel Killingun, por edhe për Uenbornin dhe Ueinburgun.

“Seddlebags”. Një kompani që i kishte rrënjët e saj në Kolorado, ku biznesi kishte filluar vite më parë duke prodhuar mallra prej lëkure të cilësisë së lartë për komunitetet që punonin në *ranch*: shalë për kuaj, rripa pantallonash, kapistra dhe këpucë, çizme kalorësish, të gjitha këto kishin stemën e markës së shquar me germën “S”.

Nga ky fillim modest, reputacioni i kompanisë dhe shitjet ishin rritur në mbarë vendin, duke ia kaluar të gjithë rivalëve. Ata kaluan në prodhimin e mallrave të tjera: valixhe, çanta dore, aksesore mode, këpucë dhe çizme. Gjithçka kishte filluar dhe kishte përfunduar me punëdore. Logoja “Seddlebags” u bë simbol statusi, në rivalitet me firmat “Gucci” dhe “Ferragamo” dhe me një etiketë çmimi të përballueshme. Fama e tyre u përhap, kështu që vizitorët për në Shtetet e Bashkuara dëshironin që të ktheheshin në shtëpi me një dhuratë vërtet mbresëlënëse, si p.sh. një çantë “Seddlebags” e bërë me dorë apo me një rrip mesi të mbërthyer me tokëz floriri.

Dhe më pas dolën thashethemet se ata po lëviznin në tregun britanik duke bërë tregti me pakicë me një apo dy dyqane të zgjedhura me shumë kujdes në Londër. Çarls Ueinburgu, shefi i Noelit, e kishte marrë vesh këtë gjë nga një burim në një darkë të shtruar në Londër. Të nesërmen në mëngjes Noeli, si president i vjetër dhe drejtor krijues, u vu në dijeni për këto lëvizje.

- Për momentin vetëm një grusht njerëzish kanë dëgjuar për “Seddlebags” në këtë vend dhe atyre u nevojitet një fushatë e shpejtë. Ne e kemi filluar mirë dhe nëse do të merremi me të, do të ecim përpara. Mbrëmë vonë bëra një telefonatë me Nju-Jorkun dhe bisedova me presidentin e “Seddlebags”-it, Harvi Klein. Ai ka rënë dakord për një mbledhje, por kërkoi një prezantim të plotë: përgatitjen e materialeve, pjesëmarrjen e medias, reklamat e të tjera. Materiale të niveli të lartë, faqe të plota të ngjyrosura. Ju keni dy javë kohë. Lidhuni me departamentin e artit dhe përpiquni të bëni diçka. Dhe për hir të Zotit, gjeni një fotograf, i cili mund ta bëjë një model burri si një njeri e jo si një trashalug vitrinash. Nëse është e nevojshme, gjeni një lojtar të vërtetë poloje. Në qoftë se ai do ta bëjë punën, nuk e kam problem se sa do ta paguajmë...

Kishte nëntë vjet që kur Noel Killingu kishte shkuar për të punuar për Uenbornin dhe Ueinburgun. Nëntë vite janë një kohë e gjatë në reklamimin e një biznesi për një njeri që qëndron në të njëjtën firmë dhe herë pas here ai habitej me veten për përparimin e tij të pandërprerë. Të tjerët, bashkëkohësit e tij, që kishin filluar me të, kishin kaluar nëpër kompani të tjera ose madje disa nga kolegët e tij kishin filluar të hapnin agjencitë e tyre. Por Noeli kishte qëndruar.

Arsyet e qëndrimit dhe të besnikërisë me firmën ishin të rrënjosura thellë në jetën e tij personale; largimin e tij nga firma e kishte konsideruar me mjaft seriozitet. Ai ishte i shqetësuar, nervoz, i pakënaqur dhe nuk ishte shumë i interesuar për punën e tij. Ai ëndërronte për fusha më të gjelbëruara, të organizohej vetë, të braktiste reklamat dhe të merrej me pasurinë. Me planet për të bërë një milion. Por ai e dinte se ishte thjesht mungesa e kapitalit të nevojshëm që e kishte tërhequr atë. Ai nuk kishte kapital dhe zhgënjimi i mundësive të humbura dhe shanseve të munguara e bënë gati që të shushatej.

Dhe më pas, katër vjet më vonë, gjërat kishin ndryshuar në mënyrë drastike. Ai ishte tridhjetë vjeç, beqar dhe ende luftonte në një mënyrë të vendosur duke e kaluar kohën në punë, i rrethuar nga një varg i madh vajzash, pa lënë që të kuptohej se kjo papërgjegjshmëri e gjërave nuk do të zgjaste përgjithmonë. Por papritur mamaja e tij vdiq dhe për herë të parë në jetën e tij Noeli e kishte gjetur veten si një njeri me shumë mundësi.

Vdekja e saj kishte qenë krejtësisht e papritur dhe për njëfarë kohe ai ishte i shokuar, dhe në një gjendje të tillë e shihte të pamundur që të binte në ujdin me faktin e ftohtë se ajo ishte larguar përgjithmonë. Ai gjithmonë e kishte dashur shumë atë në mënyrë të logjikshme dhe joesentimentale, por më thellë e kishte menduar si një burim të përhershëm ushqimi, pijesh, rrobash të pastra, krevat të ngrohtë kur ai kërkonte mbështetje morale. Por ndërkohë kishte respektuar pavarësinë e shpirtit të saj dhe faktin se ajo asnjëherë nuk kishte ndërhyrë në jetën private të Noelit të rritur. Në të njëjtën kohë, shumë nga sjelljet e matufosura të nënës së tij e kishin çmendur. Zakonisht, më i keqi ishte zakoni për të mbledhur rreth vetes njerëz të këqij dhe interesaxhinj. Noeli i quante ata qylaxhinj gjakësorë, por ajo nuk e merrte në konsideratë sjelljen e tij cinike. Beqaret pa shpresa, gratë e reja të vetmuara, artistët trokë, pa para, dhe aktorët e papunësuar i afroreshin asaj tamam si mola. Zemërgjerësinë e saj për të gjithë, ai e kishte konsideruar egoiste dhe budallallëk, sepse kurrë nuk dukej që ajo

të kishte para për të shpenzuar për gjërat që Noeli besonte se ishin të një rëndësie kryesore në jetë.

Kur ajo vdiq, edhe testamenti i saj pasqyronte atë bujari pa mend. Një pasuri e madhe i ishte lënë një djali të ri... që s'kishte të bënte fare me familjen... të cilin ajo e kishte marrë në mbrojtje dhe për ndonjë arsye ajo kish dashur ta ndihmonte.

Për Noelin, kjo ishte një goditje e hidhur. Ndjenjat dhe xhepi i tij ishin dëmtuar; ai ishte i konsumuar nga fyerja dhe pakënaqësia ndaj të cilave ishte tërësisht i pafuqishëm. Nuk ia vlente që të zemërohej, sepse ajo tashmë nuk jetonte më. Ai nuk mund ta diskutonte më vendimin e saj, ta akuzonte për mungesë besnikërie, ta akuzonte për atë ndëshkim të mallkuar që i kishte bërë. Mamaja e tij kishte lëvizur përtej mundësive të tij. Ai e imagjinonte atë, të sigurt nga zemërimi i tij, tek kalonte një humnerë ose një lumë të pakalueshëm, të rrethuar nga drita e diellit, fushat, pemët, gjithçka që përbënte konceptin e saj personal të parajsës. Tashmë ajo ndoshta shfaqej me sjelljen e saj të butë, duke qeshur me të birin, sytë e saj të errët shkëlqenin nga kënaqësia dinake, e patrazuar si gjithmonë nga kërkesat dhe qëndrimet e tij.

I mbetur vetëm me dy motrat e tij, por si për ta përkeqësuar edhe më shumë gjendjen familjare, edhe motrave u ktheu kurrizin dhe kështu në vend të familjes u përqendrua në të vetmin element të qëndrueshëm, të mbetur në jetën e tij, te puna. Si për surprizën e tij dhe habinë e superiorëve, ai zbuloi pikërisht në kohë se jo vetëm që ishte i interesuar për reklamat, por ishte jashtëzakonisht mirë me to. Kur çifligu i mamasë së tij u shit pjesa që i takonte u depozitua e sigurt në bankë, fantazitë rinore të kumarit dhe fitimet e shpejta ishin venitur përgjithmonë. Po kështu, Noeli e kishte kuptuar se të bësh para me pasurinë hipotetike të një njeriu tjetër, në fakt ishte shumë e ndryshme se të ndaheshe nga kursimet e tua. Ai ndihej i mbrojtur për llogarinë e tij bankare, sikur të ishte fëmijë dhe nuk do ta rrezikonte sigurinë e tij. Në vend të saj, në një mënyrë modeste, ai bleu për veten e tij një makinë të re dhe tentoi që të bënte kërkime për të gjetur një vend të ri për të jetuar...

Jeta vazhdonte të lëvizte. Por rinia kishte kaluar dhe ishte një tjetër jetë, e ndryshme. Gradualisht Noeli po mësohej me të dhe në të njëjtën kohë, zbuloi se nuk ishte në gjendje që të mbante zemërim pa fund kundër nënës së tij, gjë që ishte tepër e lodhshme. Dhe në fund të ditës ai duhej të pranonte se jo gjithçka kishte qenë e keqe. Për më tepër e kishte marrë malli

për të ëmën. Gjatë viteve të fundit e kishte parë shumë pak, e mbyllur siç ishte ajo në thellësi të Gluçestershajerit, por ende ishte gjithmonë atje, në pritje të ndonjë telefonate, ose kur në fund të një udhëtimi të gjatë ndieje se nuk mund të duroje rrugët e nxehta të Londrës asnjë minutë më tepër. Nuk kishte rëndësi nëse shkoje vetëm, ose merrje me vete shumë shokë për në fundjavë. Gjithmonë kishte vend të mjaftueshëm: një mikpritje e ngrohtë, ushqim i shijshëm, gjithçka ose asgjë për të bërë, zjarret të flakëronin, lule me aromë, banja të nxehta, krevate të ngrohta dhe të rehatshme verore dhe biseda të këndshme.

Gjithçka kishte kaluar, shtëpia dhe kopshti u ishin shitur të huajve; aroma e ngrohtë e kuzhinës së saj dhe ndjenjat e mira. Ishte larguar i vetmi njeri në botë pa të cilin kurrë nuk merrej asnjë vendim i vetëm. Jeta pa të, e çmendur dhe kryeneçe si kishte qenë ajo, ishte sikur të bëje një jetë me boshllëqe dhe ai kujtonte me hidhërim se do të mësohej edhe me të.

Rënkoji. E gjitha kjo iu duk se kishte ndodhur shumë kohë më parë. Në një botë tjetër. E kishte mbaruar uiskin e tij dhe ishte ulur të vështronte në errësirë. Iu kujtua kur ishte katër vjeç dhe ishte i sëmurë me fruth dhe se si netët e sëmundjes dukeshin po kaq të gjata sa e gjithë jeta, çdo minutë zgjatej sa një orë dhe agimi ishte pafundësisht larg.

Tani, tridhjetë vjet më vonë, ai po vështronte agimin. Qielli u ndriçua dhe dielli zbriti nga horizonti fals i reve dhe gjithçka u shndërrua në të kuqe ndërsa drita të verbonte sytë. Ai po vështronte agimin dhe i ishte mirënjohës, sepse kishte përzënë natën dhe tashmë ishte dita tjetër dhe nuk duhej të flinte. Njerëzit rreth tij po lëviznin, stjuardesat e avionit erdhën pranë tij me lëng portokalli dhe me peceta të lagura me ujë të ngrohtë. Ai fshiu fytyrën e tij dhe ndjeu qimet e mjekrës. Të tjerët po grumbullonin sendet e tyre, morën çantat, disa shkuan në banjë për t'u larë apo rruar. Noeli qëndroi atje ku ishte. Do të rruhej kur të arrinte në shtëpi.

Gjë të cilën e bëri tri orë më vonë. I lodhur, pis dhe i zhubrosur doli nga taksia dhe pagoi shoferin. Ajri i mëngjesit ishte i freskët, jo si ajri i Nju-Jorkut, ishin të bekuar për freskinë dhe po binte një shi i lehtë. Në sheshin “Penburg”, pemët lulëzonin, trotualet ishin të lagura. Ai ndjeu freskinë dhe ndërsa taksia po largohej, qëndroi për një moment dhe mendoi se do ta kalonte ditën vetëm për të rimarrë veten. Pasi të merrte një sy gjumë do të bënte një shëtitje të gjatë. Por kjo gjë nuk mund të bëhej, kishte punë për të

bërë. Zyra dhe shefi i tij po e prisnin. Noeli mori çantën dhe valixhen e tij, zbriti poshtë nëpër shkallë dhe hapi derën e parë që kishte përballë.

Ishte një apartament me kopsht, sepse në pjesën e pasme të tij dyert prej xhami të çonin në një verandë të vogël, pjesa e kopshtit më të madh të shtëpisë. Në mbrëmje, dielli binte mbi të, por në këtë orë të hershme ajo ishte në hije dhe macen e katit të sipërm e kishte zënë gjumi në një nga karriget ku me sa dukej kishte kaluar edhe natën.

Nuk ishte një apartament i madh, por dhomat ishin me hapësira të mjaftueshme: një dhomë ndenjjeje dhe një dhomë gjumi, një kuzhinë e vogël dhe një banjë. Gjatë natës, mysafirët duhej të flinin në divan, një pjesë e të cilit kthehej në krevat dopio. Zonja Musprat, që merrej me këto punë, kishte qenë në shtëpi, ndaj dhe shtëpia ishte e pastër, por pa ajër dhe të zihej fryma.

Ai hapi derën prej xhami dhe e përzuri macen, hapi valixhen në dhomën e gjumit dhe nxori çantën e tij. U zhvesh dhe i hodhi rrobat e palara mbi dysheme. Lau dhëmbët në banjë, bëri një dush të ngrohtë dhe u rrojti. Tashmë kishte nevojë më shumë se për çdo gjë tjetër për një kafë të zezë. I veshur me robdëshambrë dhe me këmbë të zbatshura hyri në kuzhinë, mbushi ibrikun me ujë së bashku me kafënë, e vuri mbi sobë dhe më pas, kur u bë gati, e zbrazti atë në filxhanin e kafesë franceze. Aroma e saj ishte dehëse dhe e këndshme. Ndërsa kafeja po filtrohej, ai mori postën dhe u ul pranë tavolinës së kuzhinës, ku po hapte të gjitha zarfet. Asgjë nuk dukej të ishte shumë urgjente. Megjithatë, ishte një kartolinë nga Gjibraltari që binte në sy. E hapi dhe pa se ishte postuar në Londër; ishte nga gruaja e Hag Peningtonit, një shok i vjetër shkollë i Noelit, i cili jetonte nën rrugën “Ovington”.

*Noel, jam përpjekur që të të telefonoj, por nuk kam marrë përgjigje. Në qoftë se nuk dëgjojmë ndonjë lajm nga ti, ju presim për darkë në datën trembëdhjetë. Nga ora shtatë e gjysmë deri në tetë. Nuk ka nevojë për smoking.*

*Me dashuri, Delia.*

Ai psherëtiu. Këtë mbrëmje. Në qoftë se nuk dëgjohej ndonjë e re. Oh mirë, deri atëherë do ta ketë zgjidhur. Dhe do të ishte më shumë kënaqësi sesa të shihte televizor. E la postën mbi tavolinë, u ngrit në këmbë dhe shkoi që të merrte kafënë e tij.

I mbyllur në zyrë, në një konferencë për pjesën më të madhe të ditës, Noeli e kishte humbur fillin se çfarë po ndodhte jashtë dyerve. Më në fund, pasi kishte dalë dhe po vinte në shtëpi me makinë përmes një trafiku të dendur, po lëvizte me shpejtësinë e hapave të breshkës. Vuri re që shiu i mëngjesit kishte pushuar dhe ishte një mbrëmje e përkryer maji. Tashmë kishte arritur në atë gjendje përtej lodhjes ku gjithçka ishte e lehtë dhe e qartë çuditërisht si fantazmë dhe perspektiva e gjumit dukej po aq e largët sa edhe vdekja. Duhej edhe një dush tjetër, një ndërrim i rrobave dhe një pije. Dhe më pas ai nuk do të merrte makinën e tij, por do të ecte deri në rrugën “Ovington”. Ajri i freskët dhe ushtrimet do t’ia nxisnin oreksin për ushqimin e mrekullueshëm që shpresonte se do ta priste atë darkë. Noeli me vështirësi mund të kujtonte kur ishte ulur në tavolinë për herë të fundit dhe kur kishte ngrënë diçka që nuk ishte një sandviç.

Ecja ishte një ide e mirë. Ai po ecte drejt fundit të rrugëve, tarracave rezidenciale dhe kopshtijeve, ku kishin çelur lulet e manjollave dhe lulet kacavjerrëse që u ishin qepur shtëpive të shtrenjta londineze. Duke ardhur drejt rrugës “Brompton” ai kaloi pranë ndërtesës “Michelin” dhe u kthye poshtë në rrugën “Wolton”; këtu hapat e tij u ngadalësuan; pushoi për të parë vitrinat e zbukuruara, galerinë e artit që shiste foto sportive, skena gjuetie, piktura vaji të labradorëve besnikë që kërcenin nëpër dëborë me fazanët në gojë të tyre. Ai qëndroi më shumë sesa kishte dëshiruar, thjesht duke i parë ato. Ndoshta të nesërmen do t’i telefononte galerisë dhe do të zbulonte çmimin e tyre. Pas pak vazhdoi ecjen.

Kur arriti në rrugën “Ovington” ora ishte tetë pa njëzet e pesë. Trotualet ishin të mbushura nga rreshtat e makinave të rezidentëve dhe nga disa fëmijë më të rritur, të cilët po ngisnin biçikletat lart e poshtë në mes të rrugës. Shtëpia e Peningtonëve ishte në pjesën e poshtme të tarracës. Ndërkohë ai pa një vajzë që zbriste poshtë në trotuar drejt tij, që kishte me vete një qen të bardhë të racës *Terier* dhe me sa dukej, ajo po shkonte në kutinë postare, sepse kishte një letër në dorë. Kishte veshur xhinse dhe këmbishë ngjyrë gri. Ai po e vështronte. Flokët e saj kishin ngjyrën e marmelatës, nuk ishte as e gjatë dhe as delikate. Në fakt nuk ishte fare tipi i Noelit. Por megjithatë, ndërsa ajo kaloi pranë tij, ai i hodhi një shikim të dytë, sepse e kishte njohur më parë, por s’po i kujtohej se ku mund të ishin takuar. Ndoshta në ndonjë mbrëmje. Flokët e saj ishin të veçantë...

Të ecurit e kishte lodhur dhe kishte nevojë të pinte diçka. Duke menduar për gjëra më të mira ai e harroi vajzën dhe i ra ziles së derës, lëvizi dorezën për ta hapur dhe qëndroi në pritje. “Përshëndetje, Delia, jam unë. Erdha”.

Dhe asgjë... Dera mbeti e mbyllur fort, gjë që ishte e çuditshme. Duke e ditur se ai ishte duke ardhur, Delia me siguri duhej ta kishte lënë derën të pakycur. I ra ziles përsëri. Dhe priti.

Kishte shumë qetësi. Noeli po thoshte me vete se ata duhej të ishin atje, por tashmë e dinte, por jo plotësisht i sigurt se asnjëri nuk do t’i përgjigjej ziles dhe mallkuar qofshin Peningtonët, që ndoshta nuk ishin në shtëpi.

- Përshëndetje!

Ai u kthye nga dera jomikpritëse. Poshtë në trotuar qëndronte një vajzë trashaluke me qenin e saj, që dukej se po kthehej nga posta ku kishin postuar një letër.

- Përshëndetje!

- Po kërkon Peningtonët?

- Më kishin ftuar për darkë

- Kanë dalë jashtë. I pashë tek po hipnin në një makinë.

Noeli e kaloi me një qetësi të zymtë këtë konfirmim të padëshiruar, që tashmë e kishte marrë me mend. I zhgënjyer dhe i poshtëruar u ndje edhe dashakeqës ndaj vajzës, ashtu si ndodh zakonisht kur dikujt i thuhet diçka e tmerrshme nga një njeri tjetër, si nga ndonjë lajmëtar mesjetar: “Ju mund të përfundonit pa kokë ose mund të punësoheshit si mish për top, për një katapultë monstrooze”.

Priti që ajo të largohej, por ajo nuk u largua. Ai mendoi, oh drej! Dhe më pas hoqi dorë, vendosi duart në xhepat e tij dhe zbriti shkallët për t’iu bashkëngjitur asaj.

Ajo kafshoi buzën.

- Sa turp. Është e tmerrshme kur ndodh një gjë e tillë.

- Nuk arrij ta imagjinoj se çfarë ka ndodhur.

- Gjëja më e keqe, - i tha ajo, me atë tonin e saj dhe e vendosur për të parë anën më të mirë të gjendjes, - është se kur ju vini në natën e gabuar, ata nuk ju presin. Edhe mua më ka ndodhur një herë dhe ishte tmerrësisht e sikletshme. Kisha ngatërruar datat.

Kjo nuk i bëri sens.

- Mendoni se unë kam ngatërruar datat?

- Kjo gjë ndodh rëndom.

- Por jo këtë herë. E mora kartolinën këtë mëngjes. Data trembëdhjetë.

- Por sot është dymbëdhjetë, - tha ajo.

- Jo, nuk është. - Ai ishte mjaft i sigurt. - Është trembëdhjetë.

- Më vjen jashtëzakonisht keq, por është dymbëdhjetë. - Ajo u ndje shumë keq, a thua se ngatërresa të ishte e gjitha për fajin e saj. - Nesër është data trembëdhjetë. Sot është e enjte, dymbëdhjetë maj.

Truri i tij i mpirë nga pija funksionoi ngadalë. E martë, e mërkurë... i marrtë dreqi sytë e mi, ajo kishte të drejtë, ditët kishin vrapuar njëra pas tjetrës dhe diku ai e kishte humbur fillin. Ai e ndjeu veten të turpëruar, por edhe budalla dhe për këtë arsye filloi të kërkonte të falur.

- Kam qenë duke punuar. Duke fluturuar. Kam qenë në Nju-Jork. Sapo jam kthyer këtë mëngjes. Ndryshimi i orës m'i ka ngatërruar gjërat në tru.

Ajo pretendoi se i vinte keq. Qeni i saj lëshoi një erë të keqe dhe lëvizi pak më tutje duke dëshiruar që të mos kishte urinuar. Flokët e saj, në dritën e diellit, dukeshin të mrekullueshëm. Vajza kishte sy ngjyrë gri me pikla jeshile dhe një lëkurë të butë, si një pjeshkë në lulëzim.

Diku. Po ku?

Ai u vrenjt në fytyrë.

- Jemi takuar gjë më parë?

Ajo buzëqeshi.

- Po, po, në fakt. Rreth gjashtë muaj më parë. Te Hathuejsat, në një kokej, në rrugën "Lincoln". Por atje kishte shumë njerëz, kështu që nuk ka arsye të më mbani mend.

Jo, ai nuk do ta mbante mend. Sepse ajo nuk ishte nga ato vajza që ti mund ta regjistroje, që do të dëshiroje të qëndroje me të, ose madje edhe të bisedoje. Përveç kësaj, ai kishte qenë në atë mbrëmje me Vanesën dhe kishte harxhuar pjesën më të madhe të kohës duke shkuar pas saj dhe nuk e kishte lejuar atë që të gjente ndonjë burrë tjetër për të darkuar.

- Shumë gjë e çuditshme. Më vjen keq. Sa e zgjuar që më mbani mend ëëë, - tha ai.

- Në fakt ishte një kohë tjetër.

Zemra e tij rrahu fort duke u frikësuar se mos bënte edhe ndonjë gafë tjetër sociale.

- Ju jeni me Uenbornin dhe Ueinburgun, apo jo? Unë përgatita një drekë për drejtorët, gjashtë javë më parë. Por ju me sa duket nuk më keni vënë re, sepse kisha veshur një përparëse të bardhë dhe shërbeja pjatat. Asnjëri nuk i vë re kuzhinierët dhe kamerierët. Është një ndjenjë e lezetshme a thua je i padukshëm, - tha vajza.



Ai e kuptoi se kjo gjë ishte e vërtetë. Tashmë, që po fillonte të ndihej më shumë miqësor me të e pyeti për emrin e saj.

- Jam Aleksa Eird.

- Unë jam Noel Killing.

- E di. Të mbaj mend që nga mbrëmja e Hathuejsave dhe në atë kohë unë shtroja tavolinat dhe shkruaja emrat e gjithsecilit mbi karta.

Noeli u mundua që ta kujtonte atë ditë të veçantë dhe iu kujtua me detaje ushqimi që ajo kishte bërë: salmon i pjekur, biftek skare i mrekullueshëm, sallatë me lakra, lëng limoni. Vetëm mendimi i gjithë këtyre ushqimeve të mira e bëri që t'i shkonte goja lëng dhe të ndiente se ishte tmerrësisht i uritur.

- Për kë punoni ju? - pyeti Noeli.

- Për veten time. Jam e pavarur.

Ajo e tha këtë gjë me krenari. Noeli shpresoi që ajo të mos vazhdonte të tregonte historinë e karrierës së saj, sepse nuk kishte nerva që të qëndronte dhe të dëgjonte. Kishte nevojë të hante, por më e rëndësishmja ishte se dëshironte të pinte. Ai duhej të kërkonte lejë dhe të largohej prej saj. U nis të fliste, por e ndërpreu vajza.

- Do t'ju pëlqente që të vinit dhe të pinit diçka me mua?

Ftesa ishte kaq e papritur saqë ai nuk iu përgjigj menjëherë. E vështroi dhe u ndesh me vështrimin e saj plot ankth dhe kuptoi që ajo ishte shumë e turpshme dhe për të bërë një propozim të tillë ndoshta ishte nisur nga kureshtja. Po kështu dhe ai u ndje i pasigurt nëse ajo po e ftonte atë në pabin më të afërt ose në ndonjë baxhë të pakëndshme të rrethuar me kolegë bashkëkohës, njëri prej të cilëve pa dyshim sapo mund të kishte përfunduar larjen e flokëve. Nuk kishte arsye përse ta angazhonte veten e tij. Ai ishte i kujdesshëm.

- Ku? - e pyeti.

- Unë jetoj dy dyer poshtë Peningtonit. Por ju dukeni sikur keni nevojë për një pije.

Për një moment harroi të ishte i kujdesshëm.

- Po, dua.

- Nuk ka gjë më të keqe sesa të vish në vendin e gabuar dhe në kohën e gabuar e duke e ditur se i gjithë faji është i yti.

Ndoshta kjo gjë duhej të ishte thënë me më shumë takt. Por ajo megjithatë ishte e sjellshme.

- Jeni shumë e mirë. - Noeli e mblodhi mendjen. - Po, do të më pëlqente shumë.

### 3

Shtëpia ishte identike me atë të Peningtonsave, me përjashtim se dera nuk ishte e zezë, por blu e errët dhe një dru dafine qëndronte në një vazo të madhe pranë saj. Ajo eci përpara tij, e hapi derën me çelës dhe ai e ndoqi brenda. Ajo mbylli derën pasi hynë dhe më pas u ndal për të zgjidhur qaforen e qenit. Qeni menjëherë shkoi për të pirë ujë te një tas i rrumbullakët që qëndronte në fund të shkallëve. Ky tas kishte të shkruar fjalën qen mbi të.

- Ai gjithmonë e bën këtë gjë kur hyn brenda. Sikur të ketë qenë duke ecur për një kohë të gjatë.

- Si e ka emrin?

- Lerri.

Qeni filloi të lëvizte duke bërë zhurmë, duke mbushur qetësinë sepse për herë të parë në jetën e tij Noel Killingu e gjeti veten pa fjalë. Ai ishte zënë gafil dhe nuk ishte i sigurt për atë çka kishte pranuar, por ndoshta jo, kjo i krijonte përshtypjen e menjëhershme të një qetësie të ngrohtë, të mbushur me shije të mirë dhe me pasuri. Kjo ishte rezidenca e madhe e Londrës, por në miniaturë. Ai pa korridorin e ngushtë, shkallët e pjerrëta, parmakët e lustruar, qilimat ngjyrë mjalti të varur në mure, një tavolinë antike ku ishte vendosur një lule e kuqe, azalea, një pasqyrë ovale mbi mur. Po këtu kishte diçka që i tërhoqi vëmendjen, një aromë, e cila e preku shumë. Lustra e shkëlqyer e dyllit, mollët, një sugjerim për një kafe të freskët. Ndoshta ishin lulet e thara të verës. Aroma e nostalgjisë së rinisë. Aroma e shtëpive që nëna e tyre kishte krijuar për fëmijët e saj.

Kush ishte përgjegjës për këtë goditje të kujtesës? Dhe kush ishte Aleksa Eird? Ishte një rast për t'u futur në një bisedë të vogël, por Noeli nuk mund të mendonte se do të fliste për ndonjë argument. Ndoshta kjo do të ishte gjëja më e mirë. Ai tashmë po priste se çfarë do të ndodhte më tej, duke pritur

që ta dërgonin lart në një dhomë të marrë me qira ose në një apartament shumë të vogël në baxhë. Ajo e lëshoi mbi tavolinë litarin e qenit dhe i foli me mirësjellje.

- Ju lutem, hyni brenda, - dhe e drejtoi atë te një dhomë që ndodhej pas derës së hapur.

Shtëpia ishte një binjake e Peningtonsave, por një mijë herë më shumë mbresëlënëse. Kjo dhomë, e ngushtë dhe e gjatë, shtrihej nga hyrja e shtëpisë deri në fund të saj. Fundi i rrugës ishte dhoma e pritjes, që ishte tepër e madhe për t'u quajtur dhomë ndenjjeje dhe pjesa tjetër fundore ishte dhomë ngrënieje. Këtu dritaret franceze të nxirrnin jashtë në një ballkon të rrethuar me hekura, që shkëlqente nga lulet e mbjella në vazo prej terakote.

Gjithçka ishte në ngjyrë ari dhe në të kuqe. Perdet e trasha, si jorganë me pupla, vareshin të mbështjella te kornizat e tyre. Divanet dhe karriget ishin të mbuluara me copat më të mira dhe mbi to ishin vendosur jastëkë. Një qoshkë ishte mbuluar me porcelan të bardhë dhe blu, dhe një dollap prej druri qëndronte i hapur; ishte i mbushur plot me letra dhe gazeta të një pronari të zellshëm.

Gjithçka ishte shumë elegante dhe e punuar me kujdes, por të paktën nuk shkonte fare me këtë vajzën jotërheqëse, veshur me xhinse dhe me një këmishë të hollë.

Noeli pastroi grykën.

- Çfarë dhome e mrekullueshme!

- Po, është e bukur, apo jo? Ju duhet të jeni të rraskapitur. - Tashmë, ndërsa ajo ishte e sigurt në territorin e saj, nuk dukej më shumë e ndrojtur. - Kapërcimi i zonave, orareve të ndryshme me avion, është vrasës. Kur babai im udhëton nga Nju-Jorku ai vjen me avionin "Concord", sepse i urren udhëtimet e natës.

- Mendoj se tani jam mirë.

- Çfarë do të dëshironi për të pirë?

- A keni uiski?

- Natyrisht që po. "Grouse" apo "Haig's"?

Ai mezi po i besonte fatit të tij.

- "Grouse".

- Po akull?

- Në qoftë se keni.

- Do të zbres në kuzhinë dhe do t'jua sjell. Nëse dëshironi t'i shërbeni vetes... ka gota... gjithçka është atje. Unë po largohem për një moment...

Ajo u largua. E dëgjoi të fliste me qenin e vogël dhe më pas u dëgjuan hapat e saj të lehtë ndërsa zbriste poshtë shkallëve për në bodrum. Gjithçka ishte e qetë. Supozohej që qeni kishte shkuar me të. Një pije. Ai lëvizi në anën tjetër të dhomës ku ishte vendosur një bufe për t'u pasur lakmi, e cila ishte e mbushur me shishe dhe me damixhanë.

Këtu ishin varur piktura të bukura me pamje nga jeta e qetë e vendit. Duke u endur nëpër dhomë, sytë i zunë një fazan argjendi të vendosur në mes të një tavolinë ovale të bukur gjeorgjiane. Ai shkoi te dritarja dhe po vështronte kopshtin poshtë. Një oborr i vogël me asfalt, me trëndafilat që i ngjiteshin murit me tulla. Ishte një tavolinë e bardhë, e madhe, e farkëtuar me hekur me katër karrige të njëjta me tavolinën, që i sillnin në mendje pamje të ushqimeve të freskëta, me verëra të mira në mbrëmjet verore.

Një pije. Në bufe ishin gjashtë damixhanë, të rreshtuar njëri pas tjetrit. Ai zgjati dorën te shishja e uiskit "Grouse", hodhi në gotë, i shtoi pak ujë me gaz dhe pastaj u kthye në dhomën tjetër. I vetmuar dhe ende kureshtar si një mace, sillej vërdallë. Ngriti perden e bukur dhe po vështronte poshtë në rrugë, më pas lëvizi drejt dollapit të librave duke lexuar titujt dhe duke u përpjekur që të gjente të dhëna për personalitetin e pronarit të kësaj shtëpie të këndshme. Romane, biografi, një libër për kopshtet, një tjetër për rritjen e trëndafilave.

Ai u ndal dhe po vriste mendjen për të gjitha gjërat. Duke i vendosur dy e nga dy së bashku ai arriti në konkluzionin e dukshëm: rruga "Ovington" i përkiste prindërve të Aleksës. Babai në disa lloje biznesi ishte mjaft i rëndësishëm. Ai udhëtonte me "Concord" dhe për më tepër, e merrte edhe gruan e tij me vete. Në atë moment ai mendoi se ata ishin në Nju-Jork. Të gjitha mundësitë ishin se sapo të mbaronin punën e vështirë dhe konferencat, ata do të fluturonin për në Barbados dhe në ishujt Virxhin për t'u çlodhur një javë në diell. Gjithçka ishte logjike në këtë vend.

Për sa i përket Aleksës ajo kujdesej për shtëpinë e tyre dhe e mbronte nga banditët. Kjo ishte e shpjgueshme përse ajo ishte vetëm dhe përse ishte kaq bujare me uiskin e babait të saj. Kur ata ktheheshin të nxirë nga dielli dhe me dhurata, ajo kthehej drejt e në shtëpi. Një banesë e përbashkët ose një vilë me tarracë në Uondsverth, apo në Klapham.

Gjithçka që ai mundi të zgjidhte me mendjen e tij. Noeli u ndje më mirë dhe mjaft i fortë për të vazhduar rrethin e investigimeve. Porcelani i bardhë dhe blu ishte nga Drezdeni. Pranë njërit prej kolltukëve qëndronte në dysHEME një shportë e mbushur plot e përplot me lloje leshrash dhe një

sixhade e punuar përgjysmë. Në pjesën e sipërme të bufesë ishin vendosur shumë fotografi. Njerëz që ishin martuar, të tjerë duke mbajtur bebet, duke bërë piknikë, me termose në duar dhe qen. Asnjëri nuk ishte i njohur. Por një fotografi i tërhoqi vëmendjen dhe për ta parë më mirë e mori në duar: një shtëpi e madhe eduardiane ishte në Virxhinia. Një shkollë muzike dukej në njërën anë, kishte dritare të hapura vertikalisht dhe një rresht dritaresh në baxhë. Hapat e drejtuan për te dera kryesore e hapur ku ishin vendosur dy langonj, të cilët dukeshin të bindur. Në peizazh dukeshin drurët dimërorë, kupola e një kisha dhe një kodër.

Shtëpia e fshatit e familjes.

Ajo po kthehej. Ai dëgjoi hapat e saj të lehtë që po ngjiteshin nëpër shkallë, vendosi fotografinë me kujdes dhe u kthye nga ajo. Hyri nga dera duke mbajtur në dorë një tabaka me një filxhan me akull, një gotë vere dhe një shishe verë të bardhë, të hapur, dhe një tabaka të vogël me arra e lajthi.

- Oh, sa mirë, keni sjellë pije!

Ajo e vendosi tabakanë mbi tavolinë prapa divanit, duke zhvendosur disa revista për t'i bërë vend. Qeni i vogël *Terier*, që në dukje ishte i përkushtuar, ngriti putrat e tij. Nuk e dinte nëse do të gjendej ndonjë gjë edhe për të.

Në atë moment ai ngriti gotën.

- Kjo ishte gjithçka që më nevojitej.

I gjori burrë!

Ajo po kërkonte disa kubikë akulli dhe i hodhi te pija e tij.

- Qëndrova këtu për faktin se ndihem pak si budalla.

- Oh, mos u bëni budalla. - Ajo i hodhi verë. - Kjo gjë mund t'i ndodhë çdo njeriu. Dhe vetëm mendoni, ju do të keni një mbrëmje të bukur që mezi do ta prisni ditën e nesërme. Do të pushoni gjatë natës dhe do të keni një ditë të gëzueshme. Përse nuk uleni? Karrigia është nga më të mirat, është e madhe dhe e rehatshme.

Ashtu ishte. Dhe çfarë lumturie, më në fund këmbët nuk do t'i dhembnin më; në jastëkët e butë dhe me një gotë pije në dorë. Aleksa zuri vend në karrigen tjetër përballë tij dhe me kurriz të kthyer nga dritarja. Papritmas qeni kërcëu mbi prehrin e saj, zuri vend dhe, më në fund, fjeti.

- Sa kohë qëndruat në Nju-Jork?

- Tri ditë.

- A ju pëlqen të shkoni atje?

- Zakonisht kthimi është shumë i lodhshëm.

- Çfarë bënit atje?